



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 53/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Vlastimir Dimić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 24.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më 22.04.2012, nga subjekti politik PDK, dega në Ferizaj, më të cilën pretendohet se subjekti politik LDK, ka vendosur posterat e saj me përmbajtje garuese për zgjedhje para fillimit të fushatës zgjedhore. Me që rast parashtruesi i ankesës aludon se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjekt Politik dhe Kandidatët e tyre dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë foton e kandidatit për kryetar komune të subjektit politik LDK, me Nr. 27 të kandidatit, në rrugën “Vëllezërit Gërvalla”, kryqëzimi me rrugën “Kadri Zeka”.

Neni 33 dhe 44 i LZP-së, Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozita ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e palejuar.**

Nga shkresat e lëndës del se pretendimet nga parashtruesi i ankesës, nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore sepse nga dispozitat e lart cekura ligjore, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është bërë shkelje e kodit të mirësjelljes ngase me LZP e as me Rregulla Zgjedhore, nuk është paraparë asnjë dispozitë ligjore, që e ndalon, sanksionon vendosjen e posterave apo fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP, PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 53/2012 më datën 24.04.2012.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Xhevdet Abazi**

